

**Ligji 30/2019 date 17.06.2019**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9723, DATË 3.5.2007,  
“PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 22, pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.”

**Neni 2**

Në nenin 26, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit ose nga administrator i shoqërisë kur autorizohet, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, me të cilat lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet mund të kryhet, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortakut apo aksionari, të cilit ato i përkasin, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.”

**Neni 3**

Në nenin 74, pas pikës 3 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 me këtë përmbajtje:

“3/1. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4/1, të nenin 22, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50.000 lekë.

3/2. Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 100.000 lekë.”

**Neni 4 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.6.2019

**Shpallur me dekretin 11212, datë 4.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.**

Botuar ne F.Zyrtare 99/2019

Dale nga shtypi 10.07.2019